



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 3 Dhjetor 2018

LETËR E HAPUR

Drejtuar: Z. Gramoz Ruçi
Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Nga: Znj. Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

I nderuar Zoti Ruçi,

Nëpërmjet medias jemi njoftuar se brenda muajit Dhjetor të këtij viti, do të konstituohen Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).

Për këtë qëllim, së shpejti në përputhje me nenet 13 dhe 111 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nga institucionet kompetente si Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme do të organizohet Mbledhja e Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve gjyqësorë ose prokurorë pranë Këshillave respektivë.

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ka qenë dy herë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Me vendimet e saj nr. 41, datë 16.05.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017, kjo gjykatë ka shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën përkatësisht nenet 5, 61, 76 pika 2, 103, 159 dhe 169 pika 5 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Por pavarësisht nga fakti se ka kaluar rreth një vit e gjysëm nga vendimi i parë i Gjykatës Kushtetuese, vakumi ligjor i krijuar në ligjin nr.115/2016 nuk është plotësuar ende.

Dispozitat e shfuqizuara nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese prekin aspekte të rëndësishme të realizimit të mbledhjes plenare të KLGJ-së dhe KLP-së, të cilat në kushtet e këtij vakumi ligjor, nuk mund të miratojnë dot aktet nënligjore normative për zbatimin e legjislacionit të reformës në drejtësi, aktet për miratimin e rregullave të tyre të brendshme, nuk mund të emërojnë dhe të ngrenë në detyrë gjyqtarët dhe prokurorët, nuk mund të miratojnë rregullat e detajuara për funksionimin e administratës së Këshillave, nuk mund të shqyrtojnë dot ankimet për vendimet e Komisioneve që krijohen në secilin Këshill etj.

Siç dihet ngritja dhe funksionimi i KLGJ-së dhe KLP-së janë të një rëndësie të veçantë. Kjo situatë do të krijonte një ngërç tepër shqetësues në funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së këtyre dy Këshillave, nga të cilët varet krijimi dhe konstituimi i SPAK-ut dhe Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar.

Por duke patur parasysh se miratimi i ndryshimeve të dispozitave të mësipërme kërkon votim të cilësuar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit sugjeron:



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1. Të merren masat për përsheptimin e shqyrtimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;
2. Të arrihet dialogu dhe konsensusi konstruktiv ndërmjet mazhorancës dhe opozitës, me qëllim që të mundësohet funksionimi i shpejtë dhe normal i KLGJ-së dhe KLP-së.

Me konsideratë,

Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

